



Cilat janë rastet kur nuk lejohet pezullimi?

Pezullimi nuk lejohet për:

- Për nëpunësit civilë në periudhë prove.
- Nëpunësit civilë të emëruar në pozicione të nivelit të ulët apo të mesëm drejtues, të rekrutuar nga jashtë sistemit të shërbimit civil të cilët nuk kanë plotësuar të paktën një vit pune në pozicionin në të cilin janë emëruar.

PEZULLIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Rruga: “Abdi Toptani”, ish-hotel “Drini”, Tiranë

Tel: +355 4226 8141

info@kmshe.al; kmshe@kmshe.al

www.kmshe.al

 04 226 8141

Cili është kuptimi i nocionit të pezullimit në shërbimin civil?

Pezullimi është një institut tjetër i rëndësishëm përse i përket ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar. Pezullimi nënkupton ndërprerje të përkohshme të marrëdhënieve në shërbimin civil. Vjen si rezultat i arsyeve të parashikuara në ligjin për shërbimin civil apo me kërkesë të nëpunësit civil.

Në cilat raste pezullohet marrëdhënia në shërbimin civil?

Rastet në të cilat është parashikuar pezullimi në shërbimin civil janë si më poshtë:

- Emërimi i nëpunësit civil në funksione që janë të përjashtuara nga shërbimi civil si: emërim në pozicion ministri, zëvendësministrit, funksionarë të emëruar nga Kuvendi, Presidenti i Republikës, Këshilli i Ministrave, ose emërim në pozicionin e ushtarakut të Forcave të Armatosura.
- Transferimi i nëpunësit civil në një organizatë ndërkombëtare, qeveri të huaj apo institucion ndërkombëtar, për shkak të nevojave të institucionit apo shtetit.
- Në zbatim të një vendimi gjyqësor përmes të cilit është urdhëruar si masë ndaluese, pezullimi i ushtrimit të detyrës nga ana e nëpunësit civil.
- Në zbatim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë për deklarimin e nëpunësit civil të zhdukur.
- Rregjistrimi në përputhje me ligjin i nëpunësit civil si kandidat në zgjedhjet vendore apo politike.
- Kur nëpunësi civil ndodhet në konflikt të vazhdueshëm të gjendjes së interesit të deklaruar nga vetë ai.
- Kur nëpunësi civil ndjek programin e formimit të thelluar pranë ASPA-s.

A ka të drejtë nëpunësi civil të kërkojë pezullimin e marrëdhënieve të tij në shërbimin civil ?

Çdo nëpunës civil ka të drejtë nëpërmjet një kërkesë të kërkojë pezullimin e marrëdhënieve në shërbimin civil në këto raste:

- Kur zhvillon veprimtari në kuadër të organizatave apo institucioneve ndërkombëtare
- Për periudha studimi më shumë se 1 muaj deri në 2 vjet, vërtetuar me dokumentin përkatës
- Për arsye shëndetësore të tij apo njerëzve të afërm të tij, të vërtetuar me dokument të lëshuar nga institucioni shëndetësor brenda apo jashtë vendit.
- Për punësim në aktivitet privat/organizata jofitimprurëse brenda ose jashtë vendit, të vërtetuar me kontratën e punës të lidhur me punëdhënësin.
- Për punësim në një pozicion të paktën të të njëjtit nivel në një institucion të administratës publike që nuk është pjesë e fushës së veprimit të legjislativitetit të nëpunësit civil.
- Për punësim si ekspertë në projekte të ndryshme brenda ose jashtë vendit, të vërtetuar me kontratën përkatëse.